

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.137/2020, “PËR BUXHETIN E VITIT 2021”, TË NDRYSHUAR”

I. MËNYRA E NDËRHYRJES

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24, datë 10.11.2006, vendimi nr.23, datë 16.4.2014 etj.

Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijojnë¹:

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;
2. Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;
3. Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;
4. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit:

Neni 101 ka parashikuar “nevojën” dhe “urgjencën” si rrethana e situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas vlerësimit të ecurisë thujse 11-mujore të treguesve makrofikalë e buxhetorë, ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2021, me fokus primar akomodimin e financimit të nevojshëm për akordimin e bonusit/shpërblimit të fundvitit për kategorinë e pensionistëve.

2. Përkohshmëria

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të

¹ Vendimi nr.24, datë 10.11.2006, i Gjykatës Kushtetuese.

shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, ky akt do të dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

II. QËLLIMI I HARTIMIT TË KËTIJ AKTI NORMATIV

Ky rishikim i buxhetit 2021, i propozuar nëpërmjet këtij akti normativ, synon:

- ✓ financimin e shpërblimit të fundvitit për kategorinë e pensionistëve, në masën 3.5 miliardë lekë;
- ✓ axhustimet mes zërave të shpenzimeve buxhetore, korente e kapitale, me synimin e optimizimit të realizimit të tyre për pjesën e mbetur të vitit 2021.
- ✓ Reflektimin në kahun e të ardhurave të një rritjeje në masën 18.2 miliardë lekë, si rezultat i performancës së kënaqshme të realizimit të zërave të tyre për 10-mujorin 2021, nga të cilat, rritja e të ardhurave tatimore propozohet në masën 18 miliardë lekë.
- Kjo rritje vjen si rezultat i performancës pozitive në arkëtimin e detyrimeve doganore dhe tatimore nga administrate fiskale. Rritja e të ardhurave doganore dhe tatimore tej parametrave të planifikuar pasqyron rimëkëmbjen e ekonomisë së vendit tonë pas krizës e pasojave që shkaktuan tërmeti i vitit 2019 dhe pandemia Covid-19. Në programimin e të ardhurave të vitit 2021 në fund të vitit 2020, por edhe në prill 2021, kur u përgatit akti normativ i ndryshimit të buxhetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë u tregua e kujdesshme, me qëllim parashikimin afatgjatë të pasojave të pandemisë dhe efektin negativ që mund të shkaktonte në ekonomi dhe në buxhetin e shtetit kohëzgjatja e kësaj pandemie. Por faktorë të tillë, si vaksinimi me ritme të shpejta i popullsisë, hapja shkallë-shkallë e ekonomisë dhe sezoni i verës, i cili rigjallëroi turizmin dhe të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë të lidhur drejtpërdrejt apo jo drejtpërdrejt me turizmin, kanë ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike dhe rritjen e të ardhurave që ekonomia ka gjeneruar për buxhetin e shtetit.
- Njëkohësisht, sektorë të tillë, si ndërtimi, përfshirë edhe rindërtimin për shkak të pasojave të tërmetit, kanë ndikuar në rritjen e qarkullimit, të importeve, të prodhimit të brendshëm, si dhe të ardhurave të buxhetit.
- Rritje ka pasur në të ardhurat doganore, ku vlen të theksojmë se rreth 80% e rritjes krahasuar me vitin e kaluar i referohet rritjes ekonomike, pra, volumit

të importeve, ndërsa vetëm rreth 20% e shtesës së të ardhurave i referohet efektit të rritjes së çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare.

- Të ardhurat tatimore për 10-mujorin e vitit 2021 u realizuan në masën 105.4% krahasuar me planin. Të ardhurat në tatimin mbi vlerën e shtuar janë realizuar 104%, megjithëse janë rimbursuar, krahasuar me vitin 2020, mbi 8 miliardë lekë më shumë. Po kështu, janë rritur të ardhurat nga akcizat, duke realizuar planin e periudhës 104%, ndërkohë që janë realizuar në nivel të kënaqshëm edhe të ardhurat nga kontributet e sigurimeve, duke realizuar programin e periudhës 108%.

III. ARGUMENTIMI I HARTIMIT TË KËTIJ AKTI NORMATIV

Akti normativ që propozohet, referuar zërave më të rëndësishëm, përcakton:

➤ në kahun e të ardhurave:

Bazuar në realizimin e planit të të ardhurave për 10-mujorin 2021, në vlerësimet për ecurinë e arkëtimeve në muajin nëntor 2021, si dhe në vlerësimet për të ardhurat e muajit dhjetor 2021, kemi propozuar:

- ✓ rritjen e të ardhurave nga skema e kompensimit të ish-pronarëve:
○ në masën 700 milionë lekë.
- ✓ rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor, në reflektim të performancës së mirë gjatë periudhës 10-mujore:
○ në masën 500 milionë lekë.
- ✓ uljen e të ardhurave nga grantet e huaja për projekte:
○ Në masën 1 miliardë lekë.
- ✓ rritjen e të ardhurave tatimore në masën 14 miliardë lekë, përkatësisht në këto zëra:

○Tatimi mbi vlerën e shtuar	+8	miliardë lekë
○Akciza	+2	miliardë lekë
○Taksa nacionale	+1.5	miliardë lekë
○Taksa doganore	+0.5	miliardë lekë
○Kontributet (fondet speciale)	+6	miliardë lekë
<u>Totali</u>	<u>+18</u>	<u>miliardë lekë</u>

➤ te shpenzimet korente:

- ✓ shtesën në masën 4.5 miliardë lekë për ISSH-në, nga të cilat 3.5 miliardë lekë për financimin e shpërblimit të fundvitit për rreth 670 000 pensionistë.
 - ✓ shtesën në masën 7 miliardë lekë për fondin e rindërtimit, me qëllim plotësimin e nevojave për financimin e projekteve në vazhdim.
 - ✓ shtesën në masën 1.4 miliardë lekë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zërin “Mirëmbajtje rrugore”, me qëllim shlyerjen e detyrimeve të akumuluar.
 - ✓ shtesën në masën 800 milionë lekë për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nga të cilat 500 milionë lekë për pagesën e furnizimit me *RapidTest*-e, dhe 300 milionë lekë për shlyerjen e vendimeve gjyqësore referuar indeksimit të munguar të pagesës së paaftësisë (PAK), në vite.
 - ✓ shtesën në masën 500 milionë lekë për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), për financimin e infrastrukturës sportive në vend.
 - ✓ shtesën në masën 340 milionë lekë për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për financimin e vijueshëm të skemës së fermerëve për vitin 2021.
 - ✓ shtesën në masën 308 milionë lekë për EKB-në, për financimin shtesë të nevojave të qirave të strehimit social në kuadër të tërmetit, për vitin 2021.
 - ✓ pakësimin në masën 3 miliardë lekë të shpenzimeve për interesa (të brendshme e të huaja), si rrjedhojë e dinamikave dhe të vlerësimit të ecurisë së treguesve të borxhit deri në fund të vitit 2021.
 - ✓ *etj.*
- te shpenzime kapitale:
- ✓ për projektet me financim të brendshëm, veçojmë:
 - financimin shtesë prej 4.4 miliardë lekësh për projektet në vazhdim për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në shkallë vendi, për përmirësimin e furnizimit me ujë të popullsisë;
 - financimin shtesë prej 3 miliardë lekësh për projektet në vazhdim në infrastrukturë në programin “Transporti rrugor”;

- financimin shtesë prej 2.6 miliardë lekësh për projektet në vazhdim të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, nga të cilat 500 milionë lekë për Polin e Drejtësisë, bazuar në kështet e përcaktuara në kontratën përkatëse.
- alokimin në masën 2 miliardë lekësh për Korporatën Shqiptare të Investimeve (AIC), në formën e transfertës kapitale për mbështetjen e projekteve të zhvillimit.
- financimin shtesë prej 500 milionë lekësh për projektet në vazhdim për digjitalizimin dhe qeverisjen elektronike tek AKSHI.
- ✓ Për projektet me financim të huaj, veçohen:
 - financimi shtesë prej 800 milionë lekësh për projektin në vazhdim me financim të huaj “Projekti i emergjencës Covid-19 me Bankën Botërore”.
 - financimi shtesë prej 600 milionë lekësh për projektin në vazhdim me financim të huaj “Qukës - Qafë Plloçë”, i cili ka ecuri të mirë për këtë vit.
 - financimi shtesë prej 500 milionë lekësh për projektin në vazhdim me financim të huaj “Ndërtim *By-Pass* i Vlorës”, i cili ka shënuar ecuri të kënaqshme gjatë 2021.
- te shpenzimet vendore:
 - ✓ pakësimin në masën 156 milionë lekë të financimit të huaj vendor për shkak të mosrealizimit të plotë deri në këtë periudhë.
 - ✓ shtesën në masën 70 milionë lekë për pjesën e taksave të ndara që i transferohen buxhetit vendor, si pasojë e realizimit të lartë të të ardhurave personale në rang vendi.
 - ✓ shtesën në masën 46 milionë lekë për transfertën e pakushtëzuar sektoriale për rrugët për Bashkinë Pogradec për një investim në vazhdim, fond i akorduar nga Kuvendi. Gjithashtu, 10 milionë lekë janë akorduar si transfertë specifike për mirëmbajtjen e rrugëve rurale.
 - ✓ shtesën në masën 30 milionë lekë për transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme për mbulimin e shpenzimeve të veprimtarive dhe të funksioneve njësite të vetëqeverisjes vendore, që nuk kanë realizuar mjaftueshëm nivelin e të ardhurave.

- ✓ shtesën në masën 500 milionë lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura sipas bashkive. Kjo shumë është shpërndarë sipas bashkive, duke marrë si kriter peshën e detyrimeve të secilës bashki ndaj totalit të detyrimit të muajit shtator 2021. Ky fond përdoret për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, duke nisur nga detyrimi më i vjetër i papaguar.

Theksojmë se, ndryshimet e propozuara nuk prekin deficitin buxhetor, i cili nuk ka pësuar ndryshime në këtë akt normativ. Kjo, nisur nga ecuria pozitive e të ardhurave buxhetore për 10-mujorin 2021 dhe pritshmëria gjithashtu pozitive e realizimit të tyre në nivel vjetor, që ka sjellë edhe mbulimin e plotë të të gjitha nevojave për financim në kahun e shpenzimeve, të akomoduarra përmes këtij akti normativ për vitin 2021.

KËSHILLI I MINISTRAVE